

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses A. S., nga Prizreni, të cilën e përfaqëson me autorizim V. O., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës K.S. "D.I." nga Prishtina, të cilën e përfaqëson me autorizim A.L., nga Prishtina, për dëmshpërblim, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, AC.nr.786/2013, datë 11.1.2016, në seancën e mbajtur më 21.4.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, AC. nr.786/2013, datë 11.1.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, AC.nr.786/2013 datë 11.1.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale Prizren, C. nr. 465/2008, datë 19.12.2012, me pjesën I të dispozitivit të të cilit është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditëses A. S. nga Prizreni dhe është obliguar e paditura KS "D.I." nga Prishtina, që paditëses t'i paguajë: për dëmin jomaterial, në emër të dhimbjeve fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, të intensitetit të rëndë, të intensitetit të mesëm dhe intensitetit të ulët, shumën prej 3.000 €, në emër të frikës së intensitetit të lartë, të mesëm dhe të ulët shumën prej 2.000 €, në emër të shëmtimit trupor të shkallës së mesme, shumën prej 2.000 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 2.000 €; për dëmin material, në emër të ndihmës së personit të huaj, shumën prej 600 €, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 600 €, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 10.200 €. Me pjesën II të dispozitivit është obliguar e paditura t'i paguajë paditësit shumën e tërësishme prej 10.200 € me kamatë, të cilën e paguan banka mbi mjetet e afatizuar, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e gjykimin të çështjes gjer në pagesën përfundimtare. Me pjesën III të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar pjesa e kërkesëpadsisë, me të cilën është kërkuar një shumë e përgjithshme prej 17.400 €, duke përfshirë pjesën e aprovuar në shumën prej 10.200 €. Me pjesën IV të dispozitivit e paditura është obliguar që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 708.64 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga dita që aktgjykimi të marrë formë të prerë, me kërcënim të përmbarimit të detyruar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë revizionin, ashtu që t'i ndryshojë shumat e aprovuara nga gjykatat e instancave më të ulëta në emër të dëmit jomaterial.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 24.8.2007, vozitësi B.S., duke drejtuar automjetin e markës "O.c." me targa..., të siguruar tek e paditura, ka shkaktuar një aksident trafiku, duke mos ua përshtatur shpejtësinë e vozitjes kushteve të rrugës dhe pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, kështu që, me të arritur në hyrje të fshatit ..., në kthesë humb kontrollin mbi automjetin, hidhet jashtë rrugës, në anën e djathtë dhe me atë rast paditësja, si bashkudhëtare, pëson lëndime të rënda trupore, të cilat, për pasojë, i kanë shkaktuar paditësës dhimbje fizike, frikë, shëmtim trupor, zvogëlim të aktivitetit jetësor me 20%, si dhe shpenzime për ushqim të përforcuar dhe nevojën për ndihmën e një personi tjetër.

Në bazë të kësaj gjendjeje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësës është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se shumica e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jomaterial dhe material, përbën shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të vet.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke konstatuar se ajo në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësës është pjesërisht e bazuar, ndërsa pretendimin e të paditurës se këto shumica janë tepër të larta i ka vlerësuar si të pabazuara, ashtu që ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se gjykatat e instancave më të ulëta drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësës është pjesërisht e bazuar. Ato në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, duke i caktuar shumica e dëmshpërblimit që duhet t'ia paguajë e paditura paditësës, të cilat arsye i mbështetë edhe kjo Gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e ekzaminoi konform dispozitës së parashikuar nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se gjykatat e instancave më të ulëta, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësës është pjesërisht e bazuar dhe mbi këtë gjendje faktike drejt janë zbatuar dispozitat e nenit 200 të LMD, lidhur me nenin 323 të LPK, përkitazi me caktimin e masës së dëmit jomaterial, ngase shumica e gjykuara janë caktuar në bazë të ekspertizës mjekësore të ekspertëve dr. Xh.S., ortoped - traumatolog dhe dr. N. F., neuropsikiatër, në bazë të intensitetit të dhimbjeve fizike, intensitetit të frikës së pësuar, shkallës së shëmtimit trupor dhe në bazë të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.

Caktimi i shpërblimit (satisfaksioni) për dëmin jomaterial përfaqëson zbatim të së drejtës materiale. Me rastin e caktimit të shumës së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jomaterial, gjykata, sipas nenit 200 të LMD, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben shpërblimi, por edhe për atë që përmes tij të mos favorizohen synimet që nuk janë në përputhje me natyrën e një shpërblimi të tillë të dëmit jomaterial dhe qëllimit shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditëses, shkallën e intensitetit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës, shëmtimit trupor dhe zvogëlimit të aktivitetit jetësor, sipas gjendjes së vërtetuar me anë të ekspertizës e duke pasur parasysh praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shumat e caktuara të shpërblimit të dëmit për paditësen nga ana e gjykatave të instancave më të ulëta, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë reale dhe në përputhje me kriteret e parashikuara sipas kësaj dispozite, për të cilën arsye ato kanë zbatuar drejt edhe të drejtën materiale.

Lidhur me shpenzimet për ushqim të përforcuar dhe për ndihmën nga një person tjetër, gjykatat e instancave më të ulëta i kanë caktuar ato në bazë të mendimit të ekspertëve dhe provave relevante, me të cilat është argumentuar se paditësja ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë nga një person tjetër, prandaj pretendimet e cekura në revizion në këtë drejtim Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
Më 21.4.2016, Rev.nr.100/2016

Kryetarja e kolegjit,
Emine Kaçiku